

PROJEKT ZBATIM

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT
DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”**



- DETYRE PROJEKTIMI
- RELACIONI TEKNIK
- PREVENTIVI I OBJEKTIT
- ANALIZAT TEKNIKE TE ÇMIMEVE
- SPECIFIKIMET TEKNIKE

DURRËS, TETOR 2018

DETYRË PROJEKTIMI

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT
DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”**

DURRËS, TETOR 2018

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”

HYRJE

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM NË LIDHJE ME STATUSIN LIGJOR TË SH.A UJËSJELLËSI DURRËS
SH.A Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, është subjekti i së drejtës tregtare që administron, menaxhon, riparon, si dhe investon në rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjetin e largimit të ujërave të ndotura për konsumatorët familjar/jofamiljar në territorin e Bashkisë Durrës, Shijak dhe pjesërisht në Bashkinë Kurbin, Krujë dhe Vorë. Ajo është e regjistruar e identifikohet në organet tatimore dhe QKB, me NIPT J61819502V. Legjislacioni kuadër që mbështet e rregullon verprimtarinë e saj janë aktet:

- a/ Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- b/ Vendim i KM nr.96, datë 21.02.2007 “Për administrimin e furnizimit me ujë të pijshëm për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë”.
- c/ Vendim i KM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.
- d/Vendimi i KM nr.379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores Cilësia e Ujit të pijshëm”
- e/ Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.31, datë 18.07.2017 “Mbi tarifatat për konsum publik për shoqërinë UK Durrës Sh.a”.
- f/ Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.28, datë 18.07.2017 “Për licensimin e Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Durrës”.
- g/ Statutit dhe aktit të themelimit të shoqërisë.
- gj/ Përfaqësohet nga data 16.10.2013 nga Administratori, shtetasi shqipëtar Spartak KOVAÇI.

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I OBJEKTIT TË DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Ndërtim i rrjetit të ujësjiellës në këto zona, duhet të bëhet pasi rrjeti është mbi 50% i amortizuar. Rrjeti shtrihet në rrugë urbane me gjërësi 6 ml dhe me trotuare 2.5 ml. Po kështu në territorin ku shtrihet rrjeti i ujësjiellës ka dhe rrjete telefonie, elektrike, KUZ, fibra interneti, si dhe vetë ujësjiellësi.

OBJEKTIVI

Qëllimi dhe objektivi i procedurës së tenderimit është hartimi i projektit, preventivit, specifikimeve teknike, analizave të zërave, planit të oranzimit të punimeve, grafikëve të punimeve, si dhe realcioneve shpjeguese për punimet e sipërmarrjes së;

Rikonstruksion i rrjetit te ujesjellesit Mulliri Bullgarit dhe 4 Rruget e Shijakut, Bashkia Shijak

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE VENDODHJA

Rehabilitimi i këtyre linjave faktikisht përfshin zëvendësimin pjesor të linjave ekzistuese të zonave që furnizohen me ujë këto lagje, për konsumatorët familjarë/jofamiljarë me kontrata ekzsituose. Përgjithësisht arsyet bazë janë:

- 1- Gjëndja e amortizuar e tubacioneve
- 2- Rrjedhjet lokale në xhunto e bashkime
- 3- Humbjet në rrjet
- 4- Ndotjet mikrobiologjike
- 5- Cilesia e ujit
- 6- Kostoja e mirëmbajtjes

PËRSHKRIMI I GJËNDJES EKZISTUESE

Pjesa e rrjetit që do të zëvensësohet, tubacioni është totalisht i amortizuar. Rreshjet, si gjithë ujërat depërtojnë në pusetat e kontrollit, gjë e cila sjell ndotjen e tubacioneve unazorë me këtë rrjet. Me raste shpesh herë të përsëritura janë bërë ndërhyrje thjesht për të rivendosur gjëndjen për momentin, për tu përsëritur në skesione të tjerë apo piketa të ndryshme të zonës në këtë objekt.

Në tërësinë e vet, të gjitha punimet e cituara, kanë nevojë për ndërtim tubacione të rinj polietileni.

KËRKESAT E REHABILITIMIT

RRJET SHPERNDARES, Pusetat e instalimit te matesave, traseja, si dhe interceptimet

Duke qënë se rrjeti ekzistues është realtivisht i dëmtuar, në zonat ku kërkohet të ndërhyet duhet një njohje e thellë e situatës, para këtyre ndërhyrjeve, e përkatësisht në punimet si më poshtë:

- Tërësia e rrjetit të trajktoreve të linjave (sigurisë). Duhet parë me përparësi gjëndja e territorit në një rrip me gjërësi 1ml ku kalon linja e tubacionit. Me qëllim që të jetë i garantuar moscënimi i infrastrukturës nëntokësore ekzistuese.
- Nga ana e projektuesit të verifikohet gjëndja ekzistuese e tubacionit, pusetave të kontrollit, shpërndarjes.
- Në lidhje me interceptimet e rrjeteve do të zbatohen në pamundësi të Eurocod, minimumi kriteret e caktuara në V.K.M nr.531 datë 7.11.1994 “Për kushtet teknike të rrjeteve kablllore urbane”

REHABILITIMI

Ndertimi do të bëhet i tillë që të përmirësojë furnizimin me ujë të banorëve, subjekteve, enteve privatë dhe publikë.

Do të konceptohet dhe projektohet rehabilitimi sipas koncepteve bashkëkohore. Gjithashtu do të projektohen dhe parashikohen të gjitha situatat dhe problematikat gjatë fazës së zbatimit të punimeve të sipërmarrjes duke dhënë edhe:

- 1- Planin e organizimit të punimeve
- 2- Afatin e dorëzimit të punimeve

DORËZIMI I PROJEKTIT

Projekti objektit të mësipërm do të hartohet në përputhje me kërkesat e kësaj detyre projektimi dhe kushteve teknike të projektimit (KTP) dhe zbatimit (KTZ).

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, Planin e organizimit të punimeve: Grafikon e punimeve:

Projekti i zbatimit do të përmbajë:

- 1- Planimetrinë aksiale në shkallë 1:1000 apo 1:500
- 2- Profili gjatësor me shkallë Horizontale 1:1000 ose 1:500, si në shkallë vertikale 1:100 ku detyrimisht të jenë hedhur këto elementë:
 - a. Parametrat hidraulik Q-prurja l/sek: Shpejtësia (v) në m/sek
 - b. Lloji tubacionit (diametri i jashtëm dhe i brendshëm, spesori)
 - c. Kuato e projektit, e tokës, vija e presionit piezometrik
 - d. Numiri piketës
 - e. Distanca pjesore në metro
 - f. Distanca progresive
 - g. Kilometrazhi
 - h. Lloji i formacionit (fortesia tokës ku kalon tubi)
- 3- Seksioni tëthorë tip, apo aty ku ndryshon në shkallë 1:20 ose 1:25 ose 1:50
- 4- Skema e punës, si dhe llogaritëse
- 5- Detaje e vizatime të tjera të nevojshme
- 6- Plani i organizimit të punimeve
- 7- Preventivin e plotë
- 8- Analizat e zërave të punës për të cilat nuk ka referenca në aktet nënligjore
- 9- Koston e mirëmbajtjes
- 10- Relacione shpjeguese

VËMËNDJE

Vizatimet e projektit përfundimtar të zbatimit duhet të përmbajë minimalisht pikat e mëposhtme:

Projekti përfundimtar i zbatimit duhet të dorëzohet si material i printuar dhe elektronik. Projekti i zbatimit do të dorëzohet në 2 kopje.

Vizatimet e projektit të zbatimit duhet të dorëzohen në format A3 përmbajtja e të cilit duhet të jetë sipas ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM nr.408/2015 e ndryshuar, për tu publikuar në rregjistrin kombëtar të territorit, me qëllim nxjerrjen e lejes së ndërtimit për subjektin zbatues pas tenderimit të punimeve të sipërmarrjes.

Ralcionet, specifikimet teknike, garfiku punimeve, analizat teknike, kostot e mirëmbajtjes, dhe preventivi do të dorëzohen në format A4.

Projekti do të dorëzohet në autoritetin kontraktor pas përfundimit të kontratës me shoqërinë projektuese.

REFERENCA, NORMA, SI DHE TERMAT E DETYRËS SË PROJEKTIMIT

- Referuar natyrës së punimeve dhe projekteve që do të realizohen këto shërbime rregullohen e normohen me VKM nr.354, datë 11.05.2016 “ Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, neni 38, grupi III tarifor, gërma (c).
- Kjo lloj kontrate shërbimi klasifikohet në grupet tarifore me kërkesa mesatare planifikuese.
- Topografia dhe rilievi është dhe mbetet detyrë e projektuesit i cili do të identifikojë në terren apo në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimeve në bashkinë Durrës sipërfaqet me bar dekorativ, pemë si dhe shkurre dekorative në këto zona.
- Depot furnizuese do të jenë ato ekzistuese
- Tubacioni do të jetë polietileni. Ku presioni jo më pak se 10 Atm. Bashkimi të bëhet me elektorfuzion.
- Pusetat e kontrollit dhe ato shpërndarëse do të jenë të përmasave 1.5*1.5*1.5 m.
- Për evatimin e materialit inert të përdoret analiza 3/158/4a e VKM nr.629/2015. Numri i banorëve në këtë zona llogaritet 2500 banorë, dhe si një zonë rurale norma të merret 150 l/ujë në ditë për banorë. Shtesa mesatare jo më shumë se 2.5% në vit. Për abonentët jofamiljarë norma të merret 4% e konsumit familjar. Sasitë e ujit për vaditje të nevojshme, sipas kategorisë, në litra/ditë do të përcaktohen nga tabela e mëposhtme:

	Sapo mbjelle	Zhvillim i plote
Livadh (fushë me bar)	4 për m2	4 për m2
Gardh me shkurre	4 për ml	8 për ml
Shkurre	8-16 për ml	4 për m2
Shkurre gjethegjëra	40-60 për bimë	4 për m2
Tropikale	60-80 për bimë	60-80 për bimë
Halore	40-60 për bimë	Periodikisht
Kopsht	3 për m2	3 për m2

- Kjo zonë nuk ka ujëra agresivë, ka nivel uji nëntokësor mbi 2.5 m thellësi por gjithsesi materiale të përshtatshme me prezenc të rekomandohen ato më poshtë:
Materiale të përshtatshme për përdorim në kontrakt me ujin e pijshëm
 - Betoni sipas DVGW W347
 - Aliazhe të lehta celiku
 - Celik
 - Plastike e përforcuar me fibra xhami
 - Plastike (PE,PP)
 - Materiale plastike që aplikohen në formë të lëngshme, me përbërje bi-komponente
 - Qelq dhe pllaka si materiale për veshje, shtresë.

K/Degës Teknike
Dr/Teknik

Ing.Lorenc FACJA
Ing.Gerald DAUTAJ

RELACIONI TEKNIK

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT
DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”**



DURRËS, TETOR 2018

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”

1. Objekti i Veprës

Objekti i kësaj Vepre Teknike është ndertimi i rrjetit kryesor dhe shperndares te kesaj zone.

Ndërhyrja në këto zonat bëhet për të:

- Furnizuar me ujë zonat e banuara,
- Përmirësuar e orarit të furnizimit me ujë,
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë,
- Përmirësimin e cilësisë së ujit,
- Eliminimi i humbjeve dhe ndotjeve të ujit në rrjet,
- Prerjen e lidhjeve të paligjshme dhe lidhjen e kontratave të reja konform modelit të ERRU-së

2. Gjëndja Ekzistuese e Furnizimit me ujë të kësaj zone.

Është e njohur problematika e garantimit të sasisë së ujit, që të mbulojë zona te banuara si nga ana sasiore ashtu dhe nga ana cilësore është një kërkesë bashkohore e furnizimit me ujë të pijshëm për të rritur nivelin e jetesës, por deri sot janë të pakta zonat që e kanë zgjidhur këtë problematike. Kjo situatë vjen jo për shkak të mungesës së ujit në burimet tona natyrore, por si pasoje e disa faktorëve nga të cilët më të rëndësishmit janë ata që paraqiten më poshtë:

1. Amortizimi i rrjeteve ekzistuese të ndërtuar para viteve '90.
 2. Rritja e nevojës për ujë pas viteve '90 me përdorimin e paisjeve elektroshtëpiake.
 3. Ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë.
 4. Mos pagesa e sasisë së ujit të konsumuar.
- ✓ Rehabilitim i Rikonstruksion i rrjetit te ujesjellesit Mulliri Bullgarit dhe 4 Rruget e Shijakut, Bashkia Shijak

Zona furnizohet me ujë nga tubacioni ekzistues DN400 celiku, tubacion ky i projektuar për të furnizuar nga Burimi Fushë Kuqe, një pjesë të Xhafzotajt dhe Shijakun. Traseja e këtij tubacioni pjesërisht kalon në zona të banuara apo rrethime subjektsh private. Për këtë arsye nga Drejtoria Teknike e UKD u krijua një komision, i cili pasi verifikoi që ky tubacion ka shumë humbje teknike dhe zona përreth nuk furnizohet në mënyrë të rregullt, si dhe pasi u krahasuan faturimet e kesaj zone me zonat rreth saj, u përpiluan projekti për ndërtimin e rrjetit kryesor dhe shpërndarës së zonës.

3. Llogaritjet e nevojave për ujë.

Për përcaktimin e prurjeve karakteristike të kanalizimit përdorim formulat e mëposhtme :

- **Prurja mesatare ditore** - $Q_{mes}^d = \frac{N \cdot n}{1000} \text{ m}^3/\text{dite}$

N – Numri i popullsisë në fund të kohës së projekimit

P – Numri aktual i popullsisë 2500 banorë

i – Shtesa natyrore e popullsisë 2.5 %

t – Periudha e projektimit – 25 vjet

n – Norma e furnizimit mesatarisht ditore – 150 l/d/banore

- **Prurja mesatare orare** - $Q_{mes}^d = \frac{Q_{mes}^d}{24} \text{ m}^3/\text{ore}$

- **Prurja mesatare në sekond** - $q_{mes.sek} = \frac{N \cdot n}{3.6 \cdot 24} \text{ l/s}$

- **Prurja maksimale në sekond** - $q_{max.sek} = q_{mes.sek} \cdot K_o \text{ l/s}$

KO – Koefiçenti i jouniformitetit KO = 2.0

Llogaritjet numerike i paraqesim në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Sasia pas 25	Norma l/dite	Qmes.dite m ³ /dite	Qmes.orare m ³ /ore	qmes.sek l/sek	Ko	qmax.sek l/sek
1	Populles	banor	2500	4600	150	690	28.8	8	2	16

Bazuar në detyrën e projektimit rritja e popullsisë është marrë 2% dhe norma e konsumit të ujit për banorë është pranuar 150 l/ditë/banor

Duke pranuar humbjet e ujit 15% në linjat e shpërndarjes, prurja llogaritëse maksimale e rrjetit të shpërndarjes do të jetë 18.4 l/s.

4. Llogaritjet hidraulike te vepres

Llogaritjet hidraulike të linjës së dërgimit janë bërë me anë të formulës Darsy – Ęeisbach që ka formën e mëposhtme :

$$Q = S \sqrt{8 \cdot g \frac{R \cdot i}{f}}$$

Q – Prurja që kalon në tub

S – Siperfaqja e prerjes tërthore të tubit

g – Nxitimi i rënis së lirë

R – Rrezja hidraulike e tubacionit

i – Pjerrësia hidraulike

f – Koefiçenti i humbjeve hidraulike që gjendet me formulën :

$$\frac{1}{f} = -2 \cdot \log \left(\frac{k}{12 \cdot R} + \frac{2.51}{R_e \sqrt{f}} \right)$$

Re – numri i Reynoldsit

e – Koeficienti i ashpërsisë që për tubacionet plastike është $k = 0.0015 \text{ m}$.

5. Përshkrim i Shkurtër i Veprave

Ky projekt parashikon të ndërhyjë me zëvendësimin e një pjese të tubacioneve ekzistues dhe linjat e shpërndarjes të cilat do të ndërtohen të reja.

- ✓ Rehabilitim i Rikonstruksion i rrjetit të ujesjellesit Mulliri Bullgarit dhe 4 Rruget e Shijakut, Bashkia Shijak

Në zonë kemi shumë ndërtime 2-3 katëshe shpërndarja e ujit tek konsumatorët do të behët me anën e tubacioneve terciare, nga banesa deri në kasetën e instalimit të matësave.

Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë kryesore, gjatë gërmimit të kanaleve dheu i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me zhavorr për të pëmirësuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet e mundëshme nga cedimet e rrugës.

Volumet kryesore të punimeve janë si më poshtë;

Nr.	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia
1	Linjat e shperndarjes		
1	Germim kanali me makineri	m ³	5,365
2	Germim kanali me krahe	m ³	1,341
3	Transport dheu deri 5 km	m ³	5,717
4	Prerje asfalt	m ²	1,555
5	Shtrese Asfatobetoni 4 cm	m ²	1,555
6	Shtrese Binderi t=6 cm	m ²	1,555
7	Shtrese çakulli mbeturine, t=10 cm	m ²	1,555
8	Shtrese stabilizanti t=20 cm	m ²	1,555
9	Shtrese me bitum 0.5 kg/m ²	m ²	1,555
10	Mbushje me material te germuar me pare	m ³	990
11	Mbushje ngjeshje me zhavorr	m ³	4,077
12	F.V Tub PE 100 RC Ø315 mm PN 16	ml	2,345
13	F.V Tub PE 100 RC Ø200 mm PN 16	ml	380
14	F.V Tub PE 100 RC Ø125 mm PN 16	ml	140
15	F.V Tub PE 100 RC Ø90 mm PN 16	ml	1,400
16	F.V Tub PE 100 RC Ø75 mm PN 10	ml	1,050
17	F.V Tub PE 100 RC Ø63mm PN 10	ml	1,460
18	F.V Tub PE 100 RC Ø50 mm PN 10	ml	1,950
2	Rakorderi ujesjellesi per lidhjen me rrjetin ekzistues, NYJET		
19	F.V. Tee CE 100 Dj (300*300*300) mm, Pn 16 at	cope	1
20	F.V. Tee PE 100 Dj (315*160*315) mm, Pn 16 at	cope	1
21	F.V. Tee PE 100 Dj (315*125*315) mm, Pn 16 at	cope	1
22	F.V. Tee PE 100 Dj (200*160*200) mm, Pn 16 at	cope	1

23	F.V. Tee PE 100 Dj (125*125*125) mm, Pn 16 at	cope	2
24	F.V. Tee PE 100 Dj (125*90*125) mm, Pn 16 at	cope	3
25	F.V. Tee PE 100 Dj (90*90*90) mm, Pn 16 at	cope	2
26	F.V. Tee PE 100 Dj (90*75*90) mm, Pn 16 at	cope	1
27	F.V. Tee PE 100 Dj (75*75*75) mm, Pn 16 at	cope	2
28	F.V Manikote EF PE 100 Dj 400 mm PN 10	cope	1
29	F.V Manikote EF PE 100 Dj 315 mm PN 10	cope	6
30	F.V Manikote EF PE 100 Dj 200 mm PN 10	cope	6
31	F.V Manikote EF PE 100 Dj 160 mm PN 10	cope	3
32	F.V Manikote EF PE 100 Dj 125 mm PN 10	cope	10
33	F.V Manikote EF PE 100 Dj 90 mm PN 10	cope	20
34	F.V Manikote EF PE 100 Dj 75 mm PN 10	cope	12
35	F.V Manikote EF PE 100 Dj 63 mm PN 10	cope	24
36	F.V Fllanxh çeliku Ø400 mm PN 10	cope	2
37	F.V Fllanxh spar Ø150 mm PN 10	cope	1
38	F.V Fllanxh rregjister Ø300 mm PN 10	cope	1
39	F.V Fllanxh rregjister Ø125 mm PN 10	cope	1
40	F.V Fllanxh rregjister Ø80 mm PN 10	cope	1
41	F.V Fllanxh-adaptor Ø400 mm PN 10	cope	1
42	F.V Fllanxh-adaptor Ø315 mm PN 10	cope	5
43	F.V Fllanxh-adaptor Ø200 mm PN 10	cope	1
44	F.V Fllanxh-adaptor Ø160 mm PN 10	cope	3
45	F.V Fllanxh-adaptor Ø125 mm PN 10	cope	6
46	F.V Fllanxh-adaptor Ø90 mm PN 10	cope	3
47	F.V Fllanxh-adaptor Ø75 mm PN 10	cope	6
48	F.V Fllanxh-adaptor Ø63 mm PN 10	cope	20
49	F.V Saraçineske Ø400 mm PN 16	cope	1
50	F.V Saraçineske Ø300 mm PN 16	cope	2
51	F.V Saraçineske Ø200 mm PN 16	cope	1
52	F.V Saraçineske Ø150 mm PN 16	cope	1
53	F.V Saraçineske Ø125 mm PN 16	cope	1
54	F.V Saraçineske Ø80 mm PN 16	cope	6
55	F.V Saraçineske Ø65 mm PN 16	cope	15
56	F.V Tronket çeliku DN 400, L=0.5 m	cope	1
57	F.V Tronket çeliku DN 300, L=0.5 m	cope	3
58	F.V Tronket çeliku DN 300, L=1.5 m	cope	1
59	F.V Tronket çeliku DN 200, L=0.5 m	cope	3
60	F.V Tronket çeliku DN 125, L=0.5 m	cope	2
61	F.V Tronket çeliku DN80, L=0.5 m	cope	1
62	F.V Tronket çeliku DN80, L= 1 m	cope	1
63	F.V Tronket çeliku DN 65, L=0.5 m	cope	3
64	F.V Tronket çeliku DN 65, L= 1 m	cope	3
65	F.V Kolektor çeliku DN 200, L=2.6 m	cope	1
66	F.V Bryl çeliku DN 400 mm PN 10	cope	2
67	F.V Bryl çeliku DN 300 mm PN 10	cope	3
68	F.V Bryl çeliku DN 200 mm PN 10	cope	6
69	F.V Bryl çeliku DN 80 mm PN 10	cope	3

70	F.V Bryl çeliku DN 65 mm PN 10	cope	8
71	F.V Reduksion PE 100 Dj 400*300 mm	cope	2
72	F.V Reduksion PE 100 Dj 300*200 mm	cope	1
73	F.V PAF (pjese e çmontueshme) DN 300 mm	cope	3
74	F.V PAF (pjese e çmontueshme) DN 200 mm	cope	1
75	F.V PAF (pjese e çmontueshme) DN 125 mm	cope	2
76	F.V PAF (pjese e çmontueshme) DN 90 mm	cope	4
77	F.V PAF (pjese e çmontueshme) DN 65 mm	cope	4
78	F.V. Mates uji Ø300 mm Pn 10 at	cope	2
79	F.V. Mates uji Ø200 mm Pn 10 at	cope	1
80	F.V. Mates uji Ø125 mm Pn 10 at	cope	2
81	F.V. Mates uji Ø80 mm Pn 10 at	cope	1
82	F.V. Mates uji Ø65 mm Pn 10 at	cope	4
83	F.V Stafe EF 200*63 PE	cope	2
84	F.V Stafe EF 200*50PE	cope	13
85	F.V Stafe EF 125*63 PE	cope	1
86	F.V Stafe EF 125*50 PE	cope	4
87	F.V Stafe EF 90*63 PE	cope	5
88	F.V Stafe EF 90*50 PE	cope	10
89	F.V Stafe EF 75*50 PE	cope	17
90	F.V Stafe EF 63*50 PE	cope	13
91	F.V Stafe EF 50*50 PE	cope	8
92	Puse kontrolli 2x2x1,5m	cope	1
93	Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m	cope	2
3	Pusete shperndarese Tip 1(me 14 dalje)		
94	Germim kanali me krahe	m ³	0.24
95	Transport dheu deri 5 km	m ³	0.24
96	Beton M-200 per bazamentin	m ³	0.175
97	F.V Kasete metalike 100*1200*25 cm δ=2.5 mm	cope	1
98	F.V Tuba e rakorderi PPRC Pn 16 f=63 mm	ml	1
99	F.V valvul ajernxjerresi 3/4"	cope	1
100	F.V kryqe PPRC Pn 16 f=63* 1/2"	cope	7
101	F.V adaptor me ngjitje PPRC f=63* 3/4" F	cope	1
102	F.V adaptor me ngjitje PPRC f=63* 2" F	cope	1
103	F.V saraçineska bronzi Ø63 mm	cope	1
104	F.V adaptor PE f=63* 1 1/2 "	cope	1
105	F.V bryll 90 PE f=63 mm	cope	1
7 cope			
4	Pusete shperndarese Tip 1(me 8 dalje)		
106	Germim kanali me krahe	m ³	0.24
107	Transport dheu deri 5 km	m ³	0.24
108	Beton M-200 per bazamentin	m ³	0.175
109	F.V Kasete metalike 100*80*25 cm δ=2.5 mm	cope	1
110	F.V Tuba e rakorderi PPRC Pn 16 f=50 mm	ml	1
111	F.V valvul ajernxjerresi 1"	cope	1
112	F.V kryqe PPRC Pn 16 f=50* 1/2"	cope	4
113	F.V adaptor me ngjitje PPRC f=50* 1" f	cope	1

114	F.V adaptor me ngjitje PPRC f=50* 1 1/2"	cope	1
115	F.V saraçineska bronzi Ø50 mm	cope	1
116	F.V adaptor PE f=50* 1 1/2 "	cope	1
117	F.V brryl 90 PE f=50 mm	cope	1
			65 cope

Gjeologjia dhe punimet topografike

Në këtë projekt, nuk është paraqitur projekti gjeologjik i terrenit ku do të kryhen punime dhe për këtë arsye, është punuar duke pasur parasysh kushtet e terrenit edhe nga studime të tjera gjeologjike në zonat përreth. Gjithashtu, për arsyen e sipërpërmendur të mosparaqitjes së projektit gjeologjik, rekomandojmë dhe theksojmë që, para tenderimit të objektit apo para fillimit të punimeve për zbatimin e këtij sistemi, të kryhet studimi gjeologjik i të gjithë zonës së punimeve, për të verifikuar kushtet gjeologjike të mjedisit ku do të punohet. Në rast se vërehen problematika, dukuri apo vlera të parametrave gjeologjikë, jo të përshtatshëm për ndërtimin e sistemit, të kontaktohet me projektuesin dhe supervizorin, për marrjen e masave përkatëse, për ndërtimin e sistemit dhe elementëve të tij, në përputhje me kushtet teknike përkatëse (K.T.Z. 26 -81 “Kushte Teknike të Zbatimit dhe Marrjes në dorëzim të Punimeve për Ndërtimin e Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve”) dhe standardet në fuqi.

Para fillimit të punimeve të bëhet verifikimi i terrenit dhe i kuotave të dhëna në projektin e sipërpërmendur, si dhe përputhshmëria e kuotave në terren, me kuotat e dhëna në projektin e sipërpërmendur, nga një inxhinier gjeodet i licencuar, në prani të supervizorit. Në fund të verifikimit të hartohet proces verbali përkatës.

Për çdo ndryshim, në kuotë, trasim etj. të projektit, të kontaktohet paraprakisht me projektuesin dhe pasi të jepet zgjidhja nga ky i fundit të mbahet një proces verbal, në prani të supervizorit, projektuesit, zbatuesit, dhe të një përfaqësuesi të porositësit.

Në rast, se vërehen ndryshime të kuotave dhe mospërputhje me projektin, të kontaktohet me supervizorin dhe projektuesin dhe të merren masat përkatëse, për zbatimin me korrektësi dhe në përputhje me kushtet teknike përkatëse (K.T.Z. 26 -81 “Kushte Teknike të Zbatimit dhe Marrjes në dorëzim të Punimeve për Ndërtimin e Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve”) apo standardet në fuqi.

Gjithashtu, të merren masat si dhe të zbatohen rreptësisht kushtet e sigurimit teknik të punimeve, sipas standarteve dhe Kushteve Teknike të Sigurimit Teknik në fuqi, qoftë për punimet e çdo lloji në sipërfaqe, ashtu edhe për punimet e çdo lloji të kryera në thellësi të kanalit apo gropave përkatëse gjatë zbatimit të objektit.

Punimet duhet të zbatohen rreptësisht me inxhinier gjeodet ose topograf të licencuar për aftësitë e tij në punime zbatimi, sipas planimetrisë, në prezencë të investitorit dhe supervizorit.

Ing. Lorenc Facja
Ing. Gerald Dautaj

ANALIZA TEKNIKE E ÇMIMEVE

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT
DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”**



DURRËS, TETOR 2018

PREVENTIVI

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MULLIRI BULLGARIT
DHE 4 RRUGET E SHIJAKUT, BASHKIA SHIJAK”**



DURRËS, TETOR 2018